

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-001/12**

**Prishtinë 8 Maj 2012**

**Në procedurën ligjore të**

**L.F.**

***Pala përgjegjëse në kërkesë/Ankuesi***

kundër

**N. (S.) J.**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, antarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/114/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA16008), të datë 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 8 maj 2012, mori këtë

## AKTGJYKIM

1- Refuzohet si e pasafatshme ankesa e L.F. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/R/114/2011, (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin. KPA16008), të datës 22 qershor 2012.

2- Obligohet pala ankuese, L.F., që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqindë e tridhjetë euro) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 23 gusht 2006, N.S.J., duke vepruar si anëtarë i familjes së L.-S. S. J., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) lidhur me pronën e mëposhtme:

- Ngastrën numër 748/1, zona kadastrale e Sofalisë, komuna e Prishtinës, me sipërfaqe të ngastrës prej 18 ari e 41 metra katror.

Paraqitësi i kërkesës ka theksuar se ajo ishte e bija e pronarit të ndjerë të pronës dhe se prona ishte humbur me 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të vitit 1998/99. Ajo ka pohuar është uzurpuar nga një person i panjohur dhe ka kërkuar ri-posedimin e saj.

Për të mbështetur kërkesën e saj ajo i ka ofruar AKP-ës këto dokumente:

- Fletën poseduese nr. 361, të lëshuar me 24 qershor 1997 nga Zyra Kadastrale e Republikës së Serbisë,
- kontratën mbi dhurimin të datës 3 qershor 1980, të lidhur ndërmjet nënës së paraqitëses së kërkesës dhe vet asaj, sipas së cilës i pari ia kishte dhuruar të dytës pronën e kërkuar,
- kopjen e planit kadastral, të datës 27 korrik 2006,
- shënimet tatimore, etj.

Më 20 korrik 2007, AKP-ja ka shkuar në ngastrën e pretenduar dhe ka vërtetuar se në kohën e vizitës në ngastër ndodhje në objekt i ndërtuar. Ata kanë vërejtur se prona ishte e uzurpuar nga L.F. – pala përgjegjëse në kërkesë, i cili ishte i pranishëm në kohën e vizitës dhe i cili ka pretenduar të drejtën ligjore ndaj pronës. Pala përgjegjëse në kërkesë ka pohuar se e kishte blerë pronë e kontestueshme

nga familja e paraqitëses së kërkesës në vitin 1999/2000, por nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi në mbështetje të kësaj deklaratë.

Më 22 qershor 2011, KKKK-ja me vendimin e tij KKKK/D/A/114/2011 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA16008) ka vendosur se kërkesa e N.S.J. ishte e bazuar, që do të thotë se ajo është pronare e pronës së kërkuar dhe e ka urdhëruar palën përgjegjëse në kërkesë që ta lirojë atë.

AKP-ja e ka vendosur se paraqitësi i kërkesës e kishte dëshmuar më sukses të drejtën e saj pronësore. AKP-ja ka konstatuar se “pala përgjegjëse në kërkesë kishte qenë në dijeni se kishte uzurpuar pronën e kërkuar dhe se prona nuk i përkiste atij, dhe se ai nuk kishte të lejen e shfrytëzimit të pronës. Prandaj, pala përgjegjëse në kërkesë duhet po ashtu ta kishte qenë e vëtdijshme se ndërtimi i këtij objekti në këtë palujtshmëri është i kundërligshëm”.

Palës përgjegjëse në kërkesë (këtëj e tutje: pala ankuese) i është dorëzuar vendimi KKKK/D/A/114/2011 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA16008) më 08 nëntor 2011. Ai ka paraqitur ankesë me 14 dhjetor 2011, duke cekur se vendimi ishte i padrejtë dhe i gabuar.

Ai nuk e konteston se paraqitësja e kërkesës është pronare e ngastrës kadastrale 748/1 me sipërfaqe prej 18 ari e 41 metra katrorë, por pohon se ai e kishte poseduar këtë tokë që nga viti 2000 dhe se kishte ndërtuar një shtëpi familjare trekatëshe. Ai i referohet shkeljes së Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80). Pala ankuese pohon se, “duke pasur parasysh se kanë kaluar më tepër se 3 vite që kur janë ndërtuar objektet – shtëpitë...ajo (pronarja e tokës) mund vetëm të kërkojë çmimin e tregut për tokën – ngastrën e tyre por jo edhe kthimin e tokës në fjalë”. Ai po ashtu pohon se demolimi i objekteve nuk do të arsyetohej në aspektin shoqëror dhe se pronarja mund të kërkojë vetëm pagesën. Pala ankuese i referohet neneve 2 dhe 5 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore. Theksimi i këtyre neneve nga paraqitësja e ankesës është përfshirë me zbatim të gabuarr të këtyre dispozitave ligjore. Kjo për shkak se çështja i referohet nenit 25 të të njejtij ligj.

#### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është paraqitur jashtë afatit të parapër ligjor (neni 186 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore).

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 parasheh si në vijim:

“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.

Palës ankuese i është dorëzuar vendimi më 8 nëntor 2011. Kështu që afati kohor ka përfunduar me 8 dhjetor 2011. Por, pala ankuese e ka paraqitur ankesën e tij me 14 dhjetor 2011, që është pas periudhës kohore të cekur më lartë. Ai nuk ka dhënë ndonjë arsyetim dhe gjykatat nuk mund të gjejë ndonjë arsye për vonesë.

Prandaj, ankesa është dashur të hedhet poshtë si e palejueshme mbi bazën procedurale (neni 13.3, nënparagrafi (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Në këtë mënyrë, Gjykata nuk duhet të vendos nëse dhe si dispozitat e nenit 25, paragrafëve 2 dhe 5 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80) janë të zbatueshme në këtë rast.

#### **Shpenzimet e procedurës:**

Në bazë të Aneksit III, nenit 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet deri në 92450: € 500 (50€ + 0,5% e € 92450 deri në maksimumin në shumë prej € 500)

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që humb rastin.

**Këshillë juridike:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Elka Filcheva-Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*